REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ARKIV/PROTOKOLLIT

Tiranë, më 24.11.2026

Lënda: Njoftim për shpallje konkursi për 1 (një) pozicion pune në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

DREJTORISË SË ZHVILLIMIT TË PROGRAMEVE DHE DIXHITALIZIMIT TË SHËRBIMEVE AKADEMIKO-SHKENCORE

KËTU

Universiteti i Sporteve të Tiranës, bazuar në Ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", neni 49, pika 1, gërma f, neni 67, pika 3, në Statutin e UST-së, kreu V, Neni 66, pika 1, në Rregulloren e UST-së, neni 44 "*Personeli Administrativ*", në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 27, datë 21.05.2021 "*Për miratimin e rregullores së rekrutimit të personelit administrativ në Universitetin e Sporteve të Tiranës*", në Vendimin e Bordit të Administrimit me nr. 58, datë 21.12.2020 "*Mbi miratimin e kritereve për hapjen e proçedurave të konkursit për punonjës pastrimi /sanitar në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse*", shpall kriteret për 1 (një) vend pune për personel administrativ, me kohë të plotë "Punonjës Pastrimi/Sanitar", në Sektorin e Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

I. Kriteret për hapjen e proçedurave të konkursit për 1 (një) pozicion pune si **"Punonjës Pastrimi/Sanitar"** në Drejtorinë e Sherbimeve Mbështetëse janë si më poshtë:

1. Të ketë mbaruar arsimin e ulët tetë (8) ose nëntë (9)-vjeçare ose arsimin e mesëm.
2. Të ketë eksperiencë pune në këtë pozicion përben avantazh.
3. Të ketë aftesi komunikimi dhe bashkëpunimi në grup.
4. Intervista.

II. Kandidatët që do të aplikojnë për vendin e punës si "Punonjës pastrimi /sanitar" duhet të dorëzojnë këto dokumenta:

a. Kërkesë për vendin e punës.
b. CV
c. Diplomë për kryerjen e shkollës së mesme ose certifikatë notash për arsimin e ulët tetë (8) ose nëntë (9)-vjeçare.
d. Dëshmi penaliteti
e. Certifikatë e gjëndjes familjare.
f. Raport mjeko ligjor, që vërteton aftësine për pune.

III. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit

Dokumentacioni i plotësuar sipas kritereve të shpallura të konkurrimit në njoftimin publik, bëhet me postë sipas afateve te shpallura:

- Dokumentacioni i dorëzuar me anë të shërbimit postar dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të ketyre kandidatëve.

IV . Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 10 (dhjetë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit në faqen Agjensisë së Prokurimit Publik.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Drejtoria, emri, mbiemri, adresa e konkurentit.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.
- Kandidatët do të njoftohen me e-mail nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit për datën e zhvillimit të intervistës.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE E ARKIV/PROTOKOLLIT